



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. 1242 prot.

Shkodër, më 06.09. 2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendim dhe relacion.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim:

“Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar ;

Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12 dt.20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” .

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,



KRYETAR

Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2023

Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar ;

Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr. 12 dt.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë shkodër dhe institucioneve të varësisë”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates ____ / ____ / 2023 , me propozim të kryetarit të Bashkisë , në mbështetje të nenit 9, pika 1.1; të nenit 33; nenit 54 germa “ç” dhe “dh”; të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ; ligjit nr.68/2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore , i ndryshuar; ligjit nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi”; VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar; VKB nr.12 dt.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”, sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër ;

VENDOSI :

1. Të miratojë ndryshimin në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar, numrin e punonjësve të bashkisë Shkodër dhe të instiucioneve në varësi të vitit 2023,sipas tabelës bashkengjitur.

2. Të miratojë ndryshimin dhe shtesën në VKB nr.12 datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” , sipas tabelave 7 dhe 8 shtese , bashkëlidhur.
3. Ndermarrja e Shërbimeve Publike, si institucion në varësi të Bashkisë Shkodër do të filloje funksionin e saj me date 01 Janar 2024, organizimi i brendshëm, struktura, organika dhe rregullorja miratohen me vendim të Kryetarit të Bashkisë.
4. Brenda katër muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, bashkia duhet të kryejë procedurat ligjore për transferimin e personelit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Bashkia Shkodër sipas ligjit 152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; dhe ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
5. Efektet financiare për funksionimin e Ndermarrjes se Shërbimeve Publike, si institucion në varësi të Bashkisë Shkodër fillojnë nga data 01 Janar 2024.
6. Efektet financiare për punonjesit e tjerë fillojnë me hyrjen në fuqi të vendimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar

Drejtorja e Shërbimeve Publike, ndjekjes se investimeve të Infrastrukturës

Alfred Sulate

Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Andrita Pajz

Drejtorja e Financës

Marta Gjydo

Drejtorja Analizës dhe Programimit Buxhetor

Enke Hoxha

Drejtorja Juridike

Bechira Japaj

Drejtorja Policisë Bashkiake

Edton Hoxha

Niveli i pagave për punonjësit e " Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike"

Emeritimi	Arsimi i larte				Arsimi i mesem			
	Kategoria	Shtesa për Pozicion			Klasa	Niveli minimal	Shtesa për vjetërsi, në përqindje	
Paga baze mujore								
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	76 500	85 500	94 500	103 500	112 500	2%	
Drejtor Drejtorie	II-b	68 000	73 750	79 500	85 250	91 000	2%	
Drejtor	III-a	40 200	50 225	60 250	70 275	80 300	2%	
Përgjegjës	III-a	40 200	50 225	60 250	70 275	80 300	2%	
Përgjegjës	III-a/1	37 000	46 225	55 450	64 675	73 900	2%	
Specialist	III-b	34 900	43 675	52 450	61 225	70 000	2%	
Specialist	IV-a	32 700	38 525	44 350	50 175	56 000	2%	
Specialist	IV-a	32 700	38 525	44 350	50 175	56 000	2%	
Përgjegjës	IV-b	30 600	33 950	37 300	40 650	44 000	2%	
Specialist	IV-b	30 600	33 950	37 300	40 650	44 000	2%	
Punonjës Administrativ								
Punonjës sekretarë, Arkivist, Magazinier						VIII	47 000	1%

Tab. 8

Niveli i pagave për punonjësit e " Ndë marrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike"

Emertimi	Arsimi i mesëm		
	Klasa	Niveli minimal	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Punonjës shërbimi, sanitare, punetorë ,	I	40 000	1%
Punetor i kualifikuar, Saldator,	II	41 000	1%
Shofer automjeti transporti nën 2.5 ton, shofer , magazinier	IV	42 500	1%
Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme , Teknik Ndertimi	V	42 800	1%
Teknik i mirëmbajtjes, Teknik i mesëm , Shofer	VI	43 200	1%
Manovrator fadrome, shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton dhe i mjeteve speciale,	VII	43 600	1%
Shofer me mjete speciale	IX	44 800	1%
Manovratorë	XIII	46 700	1%

Shtesa për vjetërsi në punë e përcaktuar në masën 1 %, të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë. Përfshihen nga kjo llogaritje vitet të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.



Ishte :

NUMRI I PUNONJESVE- Viti 2023

Institucioni	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	429	33
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	34	18
Dega Ekonomike e Kultures	35	
Teatri "Migjeni"	38	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	229	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	247	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	42	
TOTALI	1054	51

Bëhet:

NUMRI I PUNONJESVE- Viti 2023

Institucioni	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	386	19
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	34	18
Dega Ekonomike e Kultures	35	
Teatri "Migjeni"	38	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	229	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	247	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	105	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	42	
TOTALI	1116	37





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. ____prot.

Shkodër, më _____.____. 2023

RELACION

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 1.1, të pikës 1, të nenit 9, të nenit 23, 24 dhe 33, të shkronjave “ç” dhe “dh” të nenit 54, të pikave 3 dhe 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ; ligjit nr. 84/2022 date 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023, te ndryshuar; ligjit 68 dt.27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” i ndryshuar; ligjit 152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi”; ligjit nr .89, date 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake" ; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara ‘Askush të mos mbetet pas’ ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”, me nr. 9322 prot, datë 04.07.2023; të VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar; VKB nr. 12 dt.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë shkodër dhe institucioneve të varësisë”, Bashkia Shkodër paraqet këtë relacion për:

Bashkia Shkodër paraqet këtë relacion për:

- I- **Krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike, si institucion në varësi të Bashkisë Shkodër** me qëllim që të sigurojë administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, trotuarëve, ndriçimit, sinjalistikës, dekorit dhe

shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane, mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta dhe varrezave publike dhe të dëshmorëve.

Me këtë organizim synojmë përmirësimin e shërbimeve dhe punëve publike në:

- Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, trotuareve dhe kanalizimeve të ujrave të bardha ,në pronësi të Bashkisë.
- Fuqizimin dhe modernizimin e ndriçimit elektrik publik dhe mirëmbajtjen, shfrytëzimin e sinjalistikës rrugore.
- Përmisimin cilësor të dekorit urban në qytet dhe njësitë administrative, sipas specifikave dhe traditës.
- Rritjen e sigurisë dhe e cilësisë së jetesës së qytetarëve.
- Përmirësimin e cilësisë së punimeve dhe shërbimeve në infrastrukture përmes administrimit dhe monitorimit të shërbimeve dhe punëve publike gjatë gjithë vitit.
- Ndërhyrje për çbllokimin e rrugëve , në rastet e emergjencave, për të garantuar një trafik normal të banorëve të qytetit dhe Njësive Administrative.
- Administrimin, monitorimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane.
- Administrimin, monitorimin e hapësirave të përbashkëta të gjelbërta për komunitetin.
- Administrimin, monitorimin e varrezave publike dhe atyre të dëshmorëve.

Avantazhet :

- Rritje e cilësisë dhe e sigurisë së shërbimit në funksion të jetesës së banorëve të Bashkisë dhe Njësive Administrative.
- Reduktim i kostos për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet përmisimit të kapaciteteve teknologjike dhe kualifikimit të burimeve njerëzore.
- Efekshmëri në zgjidhjen me të shpejtë të problematikave dhe situatave emergjente që mund të krijohen.
- Përmirësim i cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet administrimit më të mirë të Burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike të bashkisë dhe të të tretëve si dhe një system monitorimi të mirë organizuar.
- Shtrirje të shërbimit gjatë gjithë vitit në gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, përfshirë Njësitë Administrative me burimet njerëzore dhe kapacitet teknike.

Kapacitetet

Ky organizim do të bëhet duke transferuar kapacitetet njerëzore nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes së Investimeve të infrastrukturës prej 69 punonjësish dhe punëtor shërbimesh. Propozohet shtesë prej 36 punonjësish dhe punëtor shërbimesh për mirëfunksionimin e aktiviteteve të kesaj drejtorie. Gjithsej numri i punonjësve dhe punëtorëve të shërbimeve të këtij institucioni do të jetë 105 punonjës .

II- Rritjen e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake me qëllim përmbushjen e detyrave dhe kompetencave sipas ligjit nr .89, date 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake".

Policia Bashkiake Shkodër ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 2003 me një efektiv prej 17 punonjësish, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 313 datë 01.07.2002

Në gusht të vitit 2015, pas Reformës Territoriale, numri i popullsisë në Bashkinë Shkodër është rreth 204.954 banorë. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodërs me 55% të popullsisë (114.085 banorë) ndërsa përta i përket njësive administrative që tashmë janë pjesë e Bashkisë Shkodër, njësia më e madhe është ajo e Rrethinave me 23.923 banorë, Guri i zi me 11.838 banorë, Postriba me 11.730 banorë, Bërdica me 9.655 banorë, Velipoja me 9.574 banorë, Dajci me 8.998 banorë, Ana e Malit me 5.968 banorë, Pulti me 3.249 banorë dhe Shalë e Shosh me 5934 banorë.

Aktualisht në varësi të problematikave që ka territori i Bashkisë Shkodër, si zënia e hapësirave publike, tregtia e paligjshme, ndotje mjedisi, ndërtime pa leje, prishje të qetësisë publike etj, me këtë numer punonjësish që ka ky shërbim, duke llogaritur kohën e punës 40 orë punë në javë, pushime javore, leje vjetore dhe ndonjë raport mjekësor, mbulojnë vetëm shërbimet e turnit të parë e të dytë kryesisht në tregjet e qytetit.

Nisur nga më sipër, me qëllim rritjen në një shkallë më të lartë të shërbimeve të Policisë Bashkiake ndaj komunitetit, si dhe të përmbushë me sukses detyrat e saj funksionale, mendojmë se duhet të shtohet numri i punonjësve të Policisë Bashkiake, gjë e cila vjen si domosdoshmëri edhe për shkak të:

- Rritjes së numrit të popullsisë së qytetit të Shkodrës, plus njësitë administrative që pas ndarjes së re territoriale janë pjesë e Bashkisë Shkodër.
- Shtimit të numrit të automjeteve në qarkullim në mënyrë progresive dhe për pasojë janë shtruar edhe kundravajtjet administrative, nevoja për rritjen dhe forcimin e masave të sigurësë rrugore.
- Zgjerimit të sipërfaqes së territorit e cila duhet të mbulohet me shërbime të Policisë Bashkiake.
- Rritjes së numrit të subjekteve juridik dhe fizik, ndaj të cilave duhet të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm për zbatimin e ligjshmërisë.
- Rritje e evidentimit të rasteve të zënies së hapësirave publike dhe shfrytëzimit të tyre në mënyrë të paligjshme.
- Kërkesave të vazhdueshme për të mundësuar konstatimin, parandalimin dhe pezullimin e ndërtimeve pa leje dhe dërgim informacioni IMT-së, për procedurë të mëtejshme.
- Rritjes së numrit të kundravajtjeve për ndotjen e mjedisit, zënien e hapësirave publike, prishje të qetësisë publike etj.
- Rritjes së numrit të gjobave të vendosura në raport më vitet më përpara, vjelja e tyre dhe për pasojë rritja e të ardhurave.

- Numrit të madh të aktiviteteve që organizohen nga/ose me lejen e Bashkisë Shkodër, ku në vazhdimësi kërkohet mbështetja e Partisë Bashkiake.
- Rritjes së numrit të ankesave të ardhura nga qytetarë apo institucione me shkresa, e-mail etj.
- Të nevojës për mbështetje dhe bashkëpunim me firma të ndryshme që kryejnë punë publike në territorin e Bashkisë Shkodër.
- Rritjes së distancës nga qendra e Bashkisë Shkodër deri në pikat ekstreme territorit të njësive administrative.

III- Për shtesë numri të punonjësve (2 punonjës me kontratë) tek punonjësit me kontratë që financohen nga donatorët, në kuadër të shpalljes së Bashkisë Shkodër fituese në thirrjen me projektin “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë”

Projekti “Fuqizimi dhe zhvillimi i shërbimeve ditore për moshën e tretë” është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Propozimi për ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve ditore për moshën e tretë në territorin e Bashkisë Shkodër vjen si nevojë në rritje për shërbime me bazë komunitare për këtë kategori në strukturat e përkujdesit shoqëror dhe si alternativë ndaj modeleve ekzistuese rezidenciale.

Pjesë e rëndësishme e projektit do të jetë krijimi i një skuadre lëvizëse me synim monitorimin e të moshuarve në komunitet, në përbërjen e së cilës do të jenë punonjës social/psikolog dhe infermierë. Specialistët e Qendrave Komunitare “Për Familjen” njohin të moshuarit në lagjen ose në njësinë administrative që mbulojnë, ndërsa skuadra lëvizëse do të mbështesë rastet më të vështira dhe me nevojë për shërbime në shtëpi.

Sa më sipër kërkojme nga ana juaj ndryshimin në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së shkodrës”, i ndryshuar ; dhe Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12 dt.20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” si më poshtë:

- Krijimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike
- Pakësim 69 nëpunës dhe punonjës shërbimesh në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës Bashkia Shkodër
- Shtesë 10 punonjës në Drejtorinë e Policisë Bashkiake dhe 2 punonjës me kontratë që financohen nga donatorët sipas tabelave bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, Ju ftoj ta votoni propozimin për miratimin e projekt vendimit.

KRYETAR
Benet BECI



Ishte :

NUMRI I PUNONJESVE- Viti 2023

Institucioni	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	429	33
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	34	18
Dega Ekonomike e Kultures	35	
Teatri "Migjeni"	38	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	229	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	247	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	42	
TOTALI	1054	51

Bëhet:

NUMRI I PUNONJESVE- Viti 2023

Institucioni	Numri i punonjesve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkoder	386	19
Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore	34	18
Dega Ekonomike e Kultures	35	
Teatri "Migjeni"	38	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	229	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	247	
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	105	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit	42	
TOTALI	1116	37

